



PERSPEKTIVAT E GAZETARËVE PËR MARRËDHËNIET KOSOVË- SERBI

RAPORT I DISKUTIMEVE NË FOKUS GRUP

Prill 2025.
Birn Serbia
Internews Kosova

Autorë: Tijana Uzelac, Kreshnik Gashi
Redaktore: Tanja Maksić
Botues: BIRN Serbia
Prill 2025

Të gjithë termat e përdorur në këtë raport në gjininë mashkullore përfshijnë si gjininë mashkullore, ashtu edhe atë femërore të personave që i referohen.

Përmbledhje

Diskutimet në grupe fokusi që u organizuan me gazetarë nga Serbia dhe Kosova theksuan se ka krizë gjithnjë e më të thelluar të lirisë së medias, e cila karakterizohet nga presioni politik, paqëndrueshmëria financiare dhe përkeqësimi i kushteve të sigurisë.

Ndërkohë që gazetarët në Serbi përballen me një mjedis mediatik të polarizuar dhe të kapur, në Kosovë, megjithëse ekziston një hapje institucionale, gazetarët raportojnë se ka etiketime politike dhe sulme fizike. Në veçanti, Serbia shënon rënie në indekset ndërkombëtare sa i përket lirisë së shtypit, ndërkohë që varësia ekonomike të donatorët e huaj krijon pasiguri shtesë, veçanërisht pas tërheqjes së mbështetjes amerikane për median.

Dy grupe fokusi janë organizuar me 20 gazetarë nga Kosova dhe Serbia për të diskutuar çështjet dhe perspektivat e lirisë së medias, cilësinë e informacionit dhe ndikimin e saj në marrëdhëniet mes njëra-tjetrës.

Ky raport thekson se lajmet e raportuara sa i përket marrëdhënieve Kosovë- Serbi janë të cilësisë së dobët dhe thellësisht të polarizuara. Lajmet mediatike dominohen nga retorika politike dhe sensacionalizmi, dhe përcillen me mungesë të analizës së thelluar, nuancave analitike, dhe këndvështrimeve të ndryshme sa i përket interesit njerëzor. Histori pozitive të bashkëpunimit ndëretnik ka fare pak dhe ato shpesh konsiderohen si të rrezikshme për t'u botuar. Gazetarët nga të dyja palët konfirmojnë dominimin e narrativave të njëanshme, veçanërisht në mediat proqeveritare. Lëvizshmëria e kufizuar, mungesa e korrespondentëve ndërkufitarë dhe bashkëpunimi minimal mes mediave serbe dhe atyre në gjuhën shqipe e përkeqësojnë më tej problemin. Dezinformimi lulëzon në këtë mjedis, duke ushqyer mosbesimin dhe duke penguar pajtimin. Mungesa e analistëve të mirëinformuar dhe të paanshëm pengon gjithashtu raportimin objektiv, duke i lënë të dy shoqëritë të keqinformuara dhe të shkëputura nga realitetet e njëra-tjetrës.

Raporti ofron disa rekomandime sa i përket përmirësimit të praktikave mediatike që synojnë nxitjen e pajtimit mes komuniteteve serbe dhe shqiptare. Në grup fokusi, gazetarët theksuan se ka nevojë për të promovuar gazetari shumë-perspektivëshe e cila, për të kundërshtuar paragjykimet e stereotipet, përfshin zëra të ndryshëm dhe rrëfime nga jeta e njerëzve të ndryshëm. Ata besojnë se edhe forcimi i bashkëpunimit mes mediave, mbështetjes së iniciativave të përbashkëta të gazetarisë dhe krijimit të rrjeteve shumë-etnike të gazetarëve do të përmirësonte kapacitetet e tyre për të raportuar lajmet mbi marrëdhëniet Kosovë- Serbi. Raporti gjithashtu bën thirrje për transparencë institucionale, zbatim të qëndrueshëm të ligjeve të medias dhe rritje të llogaridhënies së akterëve politikë dhe mediatikë. Financimi afatgjatë dhe programet e shkëmbimit të gazetarëve u identifikuan si veprime kritike për të mundësuar punën në terren, për të ndërtuar besimin dhe prodhimin e raportimeve mirëkuptuese, empatike e cilësore në të gjithë rajonin.

Konteksti politik dhe mjedisi i përgjithshëm për zhvillim të medias

Liria e medias paraqet aspekt kyç të shoqërive demokratike, sepse siguron lirinë e shprehjes dhe qasjen në informacion të larmishëm, që është me rëndësi thelbësore për publikun. Megjithatë, gjatë viteve të fundit, studiuesit anëmbanë botës kanë evidentuar një trend shqetësues të rënies së lirisë dhe pavarësisë së medias, që është manifestuar me presione politike, varësi financiare dhe censurë, të cilat kufizojnë hapësirën për raportim të lirë e të paanshëm. Raporti tregon se Kosova dhe Serbia nuk bëjnë përjashtim nga këto trende.

Në vitet e fundit, të dyja vendet kanë shënuar progres të ngadalshëm në proceset e normalizimit, madje edhe kthim prapa në demokratizim dhe liri të medias (kjo është dokumentuar veçanërisht mirë në Serbi).

Sipas raportit të publikuar nga organizata “Freedom House 2025”, [Serbia](#) klasifikohet si vend “pjesërisht i lirë”. Ky raport thekson se partia në pushtet në Serbi minon të drejtat politike dhe liritë civile, duke ushtruar presion mbi median e pavarur, opozitën politike dhe organizatat e shoqërisë civile. Po i njëjti raport nënvizon se Partia Progresive Serbe (SNS) dhe Presidenti Aleksandar Vuçiç e kanë forcuar kontrollin mbi institucionet shtetërore dhe median, duke kontribuar drejtpërdrejt në prapakthim demokratik.

Megjithatë, që nga fundi i vitit 2024, sidomos pas shembjes së strehës së stacionit hekurudhor në Novi Sad që i mori jetën 16 personave, partia në pushtet është përballur me shtim të pakënaqësisë publike. Kjo vërehet në bllokadat dhe protestat e studentëve të cilët po kërkojnë reagim institucional ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar. Studentët dhe qytetarët tjerë serbë kanë hyrë tashmë në muajin e gjashtë të protestave masive dhe bllokimeve të rrugëve.

Në anën tjetër, Kosova vazhdon të ndërtojë shtylla demokratike, duke përfshirë zgjedhje të rregullta dhe mjedis politik pluralist. Në zgjedhjet e fundit të mbajtura në shkurt të vitit 2025, fituese u shpall Lëvizja Vetëvendosje e udhëhequr nga Albin Kurti. Sipas raportit të “Freedom House 2024”, [Kosova](#) vazhdon të mbajë vendin e saj në renditjen e kësaj organizate, e cila bazohet në metodologji të caktuar, dhe mbetet në vendin e 60të. Kjo renditje do të thotë se Kosova konsiderohet regjim tranzicional apo hibrid, shtet pjesërisht i lirë ku akoma ekzistojnë shqetësime lidhur me sundimin e ligjit, korrupsionin dhe funksionalitetin institucional.

Albin Kurti, pas përfundimit të mandatit, [dha dorëheqje nga posti i Kryeministrit të Kosovës](#) për ta lehtësuar formimin e Kuvendit të ri më 15 prill 2025. Si kryeministri ashtu edhe kabineti qeveritar duhet të japin dorëheqje para se të betohen si deputetë të legjislaturës së nëntë të Kuvendit të Kosovës.

Përderisa në vitin 2023, organizata ndërkombëtare Transparency International (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit), kishte theksuar probleme të vazhdueshme të korrupsionit në sektorin publik të [Kosovës](#), raporti i vitit 2024 shënoi nivel më të ulët korrupsioni, duke treguar njëfarë përparimi.

Trendet në zhvillim të medias

Në Kosovë, liria e medias është nën kërcënim nga ndikimi politik mbi organet e pavarura, nga paditë e ashtuquajtura SLAPP (Strategic Lawsuit Against Public Participation) – të cilat kanë për qëllim të dekurajojnë persona apo agjenci nga publikimi i lajmeve, nga qasja e pamjaftueshme në informacion dhe rritja e sulmeve fizike ndaj gazetarëve. Pavarësia mediatike komprometohet nga rregullore të dobëta dhe varësi ndaj alokimit të fondeve publike në baza partiake. Gjatë vitit 2024, Kosova shënoi rënie të pavarësisë së transmetuesit publik, pasi që ish-Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së dha dorëheqje duke përmendur presionin politik. Nga ana tjetër, drejtimin e televizionit e mori Rilind Gërvalla, i cili pati deklaruar publikisht se, si donator, ka financuar Lëvizjen Vetëvendosje, partinë në pushtet në Kosovë.

Tregu mediatik serb, i cili megjithëse sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve numëron mbi 2,100 media të regjistruara, është shumë i polarizuar dhe shpesh përshkruhet si i “kapur” nga partia në pushtet. Gazetarët e pavarur serbë veprojnë në mjedis politik shumë të fragmentuar,

ku rregullisht përballen me presione dhe sulme në jetën profesionale, sidomos gjatë krizave politike. Anëtarët e partisë në pushtet shpesh sulmojnë gazetarët, si në konferenca për shtyp ashtu edhe përmes mediave që janë pro-regjimit, duke i akuzuar për anshmëri ose për përhapje të informacionit të rremë, dhe duke krijuar kështu atmosferë frike.

Trendet negative që u përshkruan më sipër janë të dokumentuara mirë nga mekanizmat ndërkombëtarë të mbikëqyrjes.

Sipas raportit të Gazetarëve Pa Kufij (Reporters Without Borders), [Serbia](#) ka rënë në listën e vendeve që garantojnë sigurinë e gazetarëve. Në vitin 2024, Serbia renditej në vendin e 98-të, krahasuar me vendin e 91-të në 2023 dhe 79-të në vitin 2022. Edhe [Kosova](#) ka shënuar rënie, nga vendi i 56-të në 2023 në vendin e 70-të në 2024.

Sipas raporteve vjetore të BE-së për vitin 2024, si Kosova ashtu edhe Serbia duhet të bëjnë përpjekje shtesë për të ecur përpara në integrimin evropian. Rekomandimet e BE-së për Serbinë përfshijnë zbatimin e plotë të ligjeve ekzistuese për median, forcimin e mekanizmave të mbrojtjes së gazetarëve dhe shmangien e shënjestrimit verbal ndaj tyre. Po ashtu, [Serbia](#) duhet të sigurojë bashkë-financim transparent e të drejtë sa i përket lajmeve me interes publik, si dhe transparencë të plotë lidhur me pronësinë e mediave dhe reklamimin. Rekomandimet për Kosovën përfshijnë përmirësimin e kapaciteteve të prokurorisë, gjyqësorit dhe policisë për trajtimin e çështjeve të lirisë së shprehjes; zhvillimin e protokolleve dhe trajnimeve për mbrojtjen e gazetarëve, duke përfshirë mekanizma të paralajmërimit të hershëm dhe reagimit të shpejtë; dhe përmirësimin e kushteve të punës për gazetarët përmes forcimit të raportimit profesional. [Kosova](#) gjithashtu duhet të zbatojë Ligjin e ri për Komisionin e Pavarur të Mediave, duke siguruar harmonizim të plotë me rregulloret dhe standardet e BE-së, dhe të rishikojë Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës me qëllim që të sigurojë financim të qëndrueshëm ndërkohë që ruan pavarësinë e tij. [Më 23 prill 2025](#), Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendosi që ta shfuqizojë Ligjin për KPM-në i cili paraprakisht ishte dërguar për rishqyrtim nga një grup i deputetëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Partisë Demokratike të Kosovës. Gjykata shpalli se disa dispozita të ligjit ishin në kundërshtim me parimet kushtetuese.

Tregjet mediatike si të Kosovës si të Serbisë mbeten shumë të varura nga paratë e shtetit, pavarësisht disa trendeve pozitive në transparencë sa i përket informacionit lidhur me pronësinë e mediave. Që nga viti 2023, Komisioni i Pavarur i Mediave në Kosovë (KPM) kërkon që çdo ndryshim në pronësinë e mediave të miratohet nga ky Komision. Një hap tjetër drejt transparencës ka qenë lansimi nga KPM në vitin 2024 i një baze publike të të dhënave lidhur me pronarët e mediave audiovizive, siç thuhet në [raportin monitorues të pronësisë mediatike “Media Ownership Monitoring 2023”](#). Në anën tjetër, i njëjti raport tregon se burimet e financimit të mediave në Kosovë shpesh janë të paqasshme për publikun, pasi si shteti si vetë mediat i fshehin këto burime. Raporti gjithashtu nënvizon se peisazhi mediatik serb dominohet nga kompani komerciale, pronarët e të cilave janë të lidhura ngushtë me qeverinë dhe partinë në pushtet.

Cilësia e informacionit dallon shumë mes njërit sistem mediatik dhe tjetrit. Sipas raportit të quajtur “Vibrant Information Barometer 2024” nga IREX, rezultati përfundimtar i [Serbisë](#) është më i ulët krahasuar me vitin e kaluar. Sa i përket cilësisë së informacionit, larmishmërisë së burimeve, edukimit mediatik, konsumit të informacionit dhe përdorimit të tij në vendimmarrjen qeveritare, Serbia ka arritur një rezultat përgjithësisht më të ulët. Në anën tjetër, [Kosova](#) ka përmirësuar cilësinë e informacionit dhe larmishmërinë e burimeve, ndërsa kriteret që lidhen me edukimin mediatik, konsumin e informacionit dhe përdorimin e tij në vendimmarrjen qeveritare kanë mbetur në të njëjtin nivel si në vitin paraprak.

Siç tregojnë të dhënat nga Picasa AI (program i zhvilluar nga Google) mediat kosovare raportojnë lajmet lidhur me dialogun Kosovë- Serbi më me intensitet se homologët e tyre serbë. Gjatë një analize të realizuar brenda një periudhe njëvjeçare, 155 media në internet në Serbi kanë prodhuar gjithsej 60,756 artikuj, ndërsa 111 media në internet në Kosovë kanë prodhuar gati trefish më shumë—167,275 artikuj, siç tregohet në tabelën 1.

	SERBIA	KOSOVA
Numri i burimeve	155	111
Numri i artikujve	60.756	167.275
Postime në media sociale	1.619	9.697
Aktivitete në Facebook	1.146.066	2.581.938

Tabela 1. Statistika lidhur me artikujt në media dhe në media sociale brenda periudhës shtator 2023-shtator 2024, Picasa AI

Diskutimet në grupe fokusi: Metodologjia

Dy grupe fokusi me gazetarë të cilët raportojnë lajme në gjuhën serbe dhe shqipe u mbajtën në shkurt të vitit 2025 dhe ato përfshinë gjithsej 20 gazetarë, me synimin që të grumbullohen reflektime më të thelluara mbi gjendjen e lirisë së medias, cilësinë e lajmeve dhe ndikimin e kontekstit politik në praktikën gazetare si në Serbi ashtu edhe në Kosovë, veçanërisht në dritën e tensioneve të vazhdueshme dhe polarizimit mediatic. Grupet u organizuan në kuadër të projektit “Nxitja e shkëmbimit ndërkulturor mediatic si gurthemel për procesin e pajtimit mes Kosovës dhe Serbisë”, të cilin e zbaton një konsorcium i OJQ-ve nga Serbia dhe Kosova.¹

Grupet e fokusit shërbyen si metodë kryesore e hulumtimit, meqë ato ofrojnë reflektime cilësore mbi qëndrimet, perceptimet dhe përvojat e pjesëmarrësve lidhur me temat e caktuara. Secili grup përbëhej nga dhjetë gazetarë nga media të ndryshme të Serbisë dhe dhjetë të Kosovës. Gazetarët konsiderohen veprimtarë të rëndësishëm që mund të nxisin ndryshime dhe të përmirësojnë cilësinë e raportimit të lajmeve, prandaj perspektivat e tyre u konsideruan si burimet më të vlefshme për këtë studim. Pjesëmarrësit u përzgjedhën në bazë të përvojës paraprake në punë gazetareske në marrëdhëniet Kosovë- Serbi, njohjes së thellë të sistemeve mediatiche dhe punës në media të besueshme e etike. Të dy grupet e fokusit u mbajtën përmes internetit dhe ato i moderuan stafi i BIRN/Internews Kosova, të cilët ndoqën metodologji të njëjtë. Pyetjet përfshinin: vlerësimin e nivelit të përgjithshëm të lirisë së medias në Serbi e Kosovë; rolin e raportimit mediatic në ndërtimin e marrëdhënieve dhe formësimin e imazhit të “tjetrit”; atë se a nxisin raportimet e lajmit bashkëpunim apo jo; a ka tema të cilat injorohen nga mediat kryesore; sa të hapura janë institucionet dhe sa e lehtë është qasja tek informacioni; paluhatja kundrejt dezinformimit; sfidat kryesore në raportimin e lajmeve lidhur me marrëdhëniet reciproke; si dhe rekomandimet për përmirësimin e praktikave gazetareske.

Në përgjithësi, tonaliteti i hulumtimit dhe i diskutimit u formësua kryesisht nga ngjarjet që i paraprinë takimit. Posaçërisht, pezullimi i ndihmës amerikane për sektorin e medias pati ndikim të madh te mediat në Kosovë e Serbi. Shumë pjesëmarrës e përshkruan këtë moment si “pikë kthese” që solli kujdes të shtuar dhe pasiguri të dukshme.

“Gati të gjitha mediat me të cilat punoj në Kosovë dhe Serbi varen në një farë mase nga këto fonde. Kur e them këtë, e kam fjalën kryesisht për mediat e vogla dhe lokale”, theksoi një prej pjesëmarrësve.

¹ Konsorciumi përbëhet nga katër organizata: Si udhëheqës, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN Serbi), Internews Kosova, Qendra për Zhvillim të Komunitetit (KoSSev) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Vojvodinës (IJAV).

Ndjenja e pasigurisë u përkeqësua më tej nga protestat studentore në Serbi, të cilat, në kohën e hartimit të këtij raporti, kishin hyrë në muajin e gjashtë. Këto protesta shtynë autoritetet të ndërmarrin veprime jodemokratike, sikurse [bastisja e zyrave të OJQ-ve](#), bërja e [përgjimeve të jashtëligjshme](#), si dhe fushata publike fyese e denigruese kundër protestuesve. Në veri të Kosovës, të gjitha institucionet serbe janë mbyllur gjatë vitit të fundit, duke vënë mediat në gjuhë serbe në pozitë të vështirë.

Për të plotësuar zbulimet që u bënë gjatë diskutimeve, ekipi hulumtues përfshiu edhe të dhëna të marra nga kompania Picasa AI, dhe kombinoi të dhënat cilësore me ato sasiore. Këto të dhëna përfshinë trajtimin e dialogut Kosovë- Serbi në mediat që bazohen në internet si dhe mediat sociale në Serbi dhe në Kosovë: numrin dhe shpeshtësinë e artikujve, numrin e postimeve në rrjete sociale dhe numrin e komenteve nga publiku, si dhe 10 mediat kryesore në secilin vend që kanë raportuar më shumë dhe kanë pasur komentet më të shumta gjatë periudhës 1 shtator 2023 – 30 shtator 2024.

Për më tepër, u krye edhe hulumtim dokumentesh e interneti, kryesisht për të bërë përmbledhje të pjesës kontekstuale të raportit dhe për të ofruar rishikim të raporteve të politikave, ligjeve e të dhënave nga terreni që ishin në dispozicion.

Si çdo metodologji, edhe kjo ka kufizimet e saj, por ofron njohuri të rralla e me vlerë, të cilat rrallëherë bëhen publike. Kufizimet përfshinë: mostra relativisht e vogël e gazetarëve që u konsultuan drejtpërdrejt; mungesa e perspektivës së profesionistëve të tjerë mediatikë, si redaktorë, pronarë etj.; fakti që diskutimet në internet kanë kufizimet e tyre krahasuar me ato ballë për ballë; dhe mospërfshirja e mediave që kanë për qëllim bërjen e bujës (tabloide), edhe pse ato kanë audiencë të gjerë.

PJESA I: Gjendja e Lirisë së Medias

Hapësirë gjithnjë e më e ngushtë për gazetari të pavarur

Liria e medias është në rënie e sipër veçanërisht gjatë dy viteve të fundit, siç konkluduan gazetarët që punojnë në media në Serbi apo në redaksi që raportojnë në gjuhën serbe në Kosovë. Gazetarët në Kosovë operojnë në sistem mediatik përgjithësisht më të mirë, por megjithatë kanë të njëjtat shqetësime lidhur me sigurinë, marrëdhëniet ndërkomunitare, ndërhyrjet në punë dhe diskreditimin. Brenda kuadrit të projektit, ekipi gjithashtu ka realizuar një analizë të përmbajtjes mediale të prodhuar nga mediat në Serbi dhe Kosovë, e cila është paraqitur më në detaje në Studimin e Rastit dhe në Raportin e publikuar në gjuhën [shqipe](#), [angleze](#) dhe [serbe](#).

Siç u theksua, autoritetet si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi ushtrojnë presion mbi mediat e pavarura, pengojnë qasjen në informacion dhe i zmadhojnë interpretimet që thellojnë ndarjet etnike. Peisazhi mediatik nuk është i përshtatshëm për dialog dhe shpërndarje objektive të informacionit për qytetarët.

“Sa i përket lirisë së medias në Kosovë, veçanërisht për ne në mediat në gjuhën serbe – të cilat janë tepër shumë për një zonë kaq të vogël, rreth 40 media gjithsej – teorikisht duket se kemi gjithë lirinë e botës. Por çështja e vërtetë është se efekti ynë është jashtëzakonisht i kufizuar.”

Pjesëmarrësi nr. 9, gazetar dhe redaktor në një media lokale që raporton në gjuhën serbe në Kosovë.

Fushata shpifëse, presion ekonomik dhe presion ligjor

Qeveritë e të dy vendeve mbështeten gjithnjë e më shumë në taktika indirekte – fushata shpifëse, presion ekonomik dhe zbatim selektiv të ligjit – për të heshtur zërat kritikë dhe gazetarinë hulumtuese. Rrjedhimisht, gazetarët e pavarur janë nën trysni të vazhdueshme psikologjike dhe profesionale.

“Po përballemi me regjime që nuk ta ndalojnë drejtpërdrejt të flasësh apo të raportosh lajme, por e bëjnë këtë duke të të frikësuar konkretisht ty. Për shembull, kur shkon te mjeku, mjeku të thotë: ‘Ah, qenke ai gazetari nga opozita.’”

Pjesëmarrësi nr. 5, gazetar nga media lokale që raporton lajme në gjuhën serbe në Kosovë.

“Si nga pala serbe, ashtu edhe ajo kosovare, mund të etiketohesh lehtësisht si spiun, si njeri që punon për Beogradin, ose si ‘serb i Kurtit’. Kjo e bën jashtëzakonisht të vështirë të bësh punën tënde dhe të mbash distancën profesionale.”

Pjesëmarrësi nr. 4, gazetar nga media lokale që raporton në gjuhën serbe në Kosovë.

Polarizimi i thellë mes mediave proqeveritare dhe atyre kritike është shumë i dukshëm, gjë që e konfirmojnë të gjithë gazetarët në redaksitë në gjuhën serbe. Etiketimi i mediave të pavarura si “armiqtë e shtetit”, “tradhtarë” apo “mercenarë” është taktikë e moçme e autoriteteve serbe për t’ua minimizuar efektin. Sipas një pjesëmarrësi, me rritjen e tensioneve politike – qoftë lidhur me Kosovën apo tema të tjera të ndjeshme – polarizimi vetëm sa thellohet.

“Vazhdimisht këmbëngulet me fjalët ‘ndikimi i huaj’... një ngjyrosje e pa fund lidhur me ‘tradhtarët’, krejtësisht e pavërtetë, totalisht absurde dhe qesharake... por për disa njerëz, definitivisht ka efekt. Gjithmonë kërkohet një armik i jashtëm, duke u thënë se paratë po vijnë nga Kroacia, Ukraina, Shqipëria – nga shumëkënd.”

Pjesëmarrësi nr. 3, gazetar i pavarur.

“Mediat opozitare, ‘mediat e Shollakut’, ‘mediat e tajkunëve’—këto etiketa përsëriten vazhdimisht. Kjo paraqet vetëm një rën anë. Ana tjetër është se mediat që përpiqen vërtet të funksionojnë si media të mirëfillta po i afrohen më shumë formave të aktivizmit shoqëror, sepse situata është bërë shumë e polarizuar.”

Pjesëmarrësi nr. 10, gazetar në një revistë javore në Serbi.

Gazetarët në Kosovë raportojnë edhe lajme lidhur me presione politike. Deklaratat e Kryeministrit Albin Kurti kundër disa mediave shihen si nxitëse kryesore sulmesh. Një gazetar shpjegoi se anëtarë të redaksisë së saj u etiketuan nga zyrtarë qeveritarë si “gazetarë serbë, të paguar nga Serbia”, dhe për pasojë institucionet refuzuan t’u përgjigjen pyetjeve të tyre.

“Këto sulme, duke përfshirë ato të Kryeministrit Kurti ndaj mediave të etiketuara si ‘serbe’, dhe mbyllja e plotë e qeverisë ndaj gazetarëve, duket se flasin për një synim që të vendoset një kontroll i plotë mbi peizazhin mediatik.”

Pjesëmarrësi nr. 11, gazetar në mediat e Kosovës.

Gjatë diskutimeve në grupe fokusi, mbi 20 padi SLAPP (padi që kanë për qëllim dekurajimin e publikut) ishin aktive kundër mediave të ndryshme në Serbi, duke shtuar trysinë ekzistuese ndaj gazetarisë së pavarur, posaçërisht në dy vitet e fundit. Këto padi kryesisht nisen nga individë, korporata apo anëtarë të establishmetit politik në pushtet, me synim shuarjen e gazetarisë së pavarur dhe shterimin financiar të organizatave mediatike.

Pjesëmarrësit në fokus grupin serb bënë me dije te rasti i fundit që përfshin Bratislav Gashiqin, ish- kreun e agjencisë serbe të inteligjencës BIA, i cili ngriti një padi kundër medias hulumtuese KRIK. Në këtë rast, gjyqtarët deklaruan se gazetarët duhet të kishin treguar “më shumë tolerancë” ndaj Gashiqit për shkak të detyrës së tij publike dhe se “gazetarët lejohen vetëm të përcjellin informacione, por jo t’u shpjegojnë lexuesve se çfarë po ndodh në të vërtetë”.

Gazetarët në Kosovë shpesh janë edhe në shënjestër të padive SLAPP (padi me qëllim të dekurajimit të publikut), ndërkaq joefikasiteti i gjykatave në trajtimin e këtyre padive parashihet si problem madhor për lirinë e mediave. Megjithatë, situata në terren ka filluar të ndryshojë pasi Këshilli Gjyqësor i Kosovës, KGJK, ka ndërmarrë hapa për trajtimin e rasteve të shpifjes në gjykata. Sipas të dhënave të fundit, mbi [50% e tyre tani janë zgjidhur](#) në gjykata, që është shenjë pozitive për përmirësimin e situatës.

Mediat në Kosovë raportojnë shqetësime sa i përket sigurisë fizike, p.sh. sulme gjatë ditës së zgjedhjeve:

“Isha në Istog gjatë zgjedhjeve. Klan Kosova kishte përgatitur kartela të dukshme për gazetarë, por na sulmuan vetëm sepse ishim pjesë e asaj medie.”

Pjesëmarrësi nr. 12, gazetar nga një televizion i Kosovës.

Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) gjatë ditës së zgjedhjeve kanë ndodhur disa incidente, shumica prej tyre të kryera nga mbështetës të partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje.

Rreziku i sigurisë nuk është incident vetëm gjatë zgjedhjeve. Nga 1 janar 2024 deri më 1 mars 2025 janë raportuar 77 raste të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve në Kosovë. Këto sulme kanë përfshirë kryesisht mesazhe urrejtjeje dhe presioni mbi gazetarët sa ata kryenin detyrën e tyre profesionale.

Gjatë grupit të fokusit të mbajtur në Kosovë, gazetarët theksuan se prania e Policisë së Kosovës në veri ka përmirësuar situatën krahasuar me vitin 2023, kur gazetarët përballeshin me sulme të konsiderueshme. Në vitin 2024, gazetarët kanë raportuar numër më të vogël incidentesh në këto zona dhe janë ndjerë më të sigurt. Megjithatë, ata kanë theksuar se dhuna ndaj gazetarëve mbetet më e përhapur në pjesën jugore të Kosovës.

Edhe atëherë kur gazetarët kosovarë vizitojnë Serbinë, lindin probleme sigurie:

“Unë them se nga pikëpamja ime personale, duke filluar nga përvoja ime e vetme udhëtimi në Serbi, ishte hera ime e parë atje dhe e gjithë familja ime më thanë: “Mos shko.” Kjo për shkak të informacionit të përgjithshëm që ata kishin, i cili u thoshte atyre se është e rrezikshme për kosovarët që të vizitonin atje. Besoj se kjo frikë është edhe rezultat i asaj se çfarë informacioni marrin qytetarët nga mediat, krahas me efektet akoma të pranishme të luftës. Ky informacion krijon frikë, qoftë të qëllimshme qoftë jo, posaçërisht për ata që nuk e dinë nëse kjo është e vërtetë apo jo.”

Pjesëmarrësi nr. 11, gazetar në mediat e Kosovës.

Brishtësia e pavarësisë financiare

Pasiguria ekonomike zmadhon edhe më tej ndjesinë e lirisë së kufizuar. Mediat e pavarura zakonisht nuk kanë qasje në fonde publike, të cilat janë të rezervuara për media proqeveritare. Mbijetesa e tyre varet nga donatorët e huaj, kryesisht nga SHBA, BE dhe programe tjera të ndihmës ndërkombëtare, por ato projekte shpesh janë afatshkurtra dhe nuk garantojnë qëndrueshmëri afatgjate.

“Një nga mënyrat si regjimi aktual në Serbi kontrollon mediat është përmes bashkë-financimit me projekte nëpërmjet ministrive e komunave. Fondet e huaja janë me të vërtetë një xhoker shpëtimi për mediat e pavarura.”

Pjesëmarrësi nr. 2, gazetar nga një gazetë ditore në Serbi.

“Edhe gazetarët, bashkë me pronarët e mediave, e kanë degraduar deri diku profesionin. Disa besojnë se për shkak se e mbështesin financiarisht një media të caktuar, ata duhet të kenë ndikim në atë që del në lajmet kryesore. Megjithatë, agjendat e lajmeve duhet të përcaktohen nga politika editoriale e medias, duke mbetur e pavarur nga çdo ndikim financiar. Askush, pavarësisht nga financimi i tyre, nuk duhet të diktojë apo të ndryshojë atë që del në lajme.”

Pjesëmarrësi nr. 13, gazetare kosovare në mediat ndërkombëtare.

Pavarësia financiare del si një nga çështjet kritike në diskutimet në grupe fokusi, sidomos në momentin kur u ndalën fondet e USAID-it dhe të organizatave amerikane, gjë që goditi fort mediat në Kosovë dhe Serbi.

“Pyetja kryesore është se si trajtimi i përgjithshëm i mediave, veçanërisht modeli financues nga donatorë të huaj, i cili dihet se vjen kryesisht nga Shtetet e Bashkuara, do ta formësojë peizazhin mediatik dhe si do të reagojë Evropa ndaj gjithë kësaj.”

Pjesëmarrësi nr. 6, gazetar në një stacion televiziv në Serbi.

Gazetarët që morën pjesë në grupe fokusi në gjuhën serbe theksuan një zhvillim tjetër që ka potencial të ndryshojë në mënyrë dramatike peisazhin mediatik. Gjatë kohës së diskutimeve të grupit të fokusit, SBB, kompani transmetuese e TV N1, e gazetës ditore Danas dhe e revistës javore Radar, iu shit Yettel-it.

“SBB-ja përbën në esencë paraqet 90 % të raportimit mediatik nga media që nuk janë të lidhura me qeverinë në Serbi. Struktura korporative e mediave nënkupton ndryshime të interesave të biznesit dhe, mendoj se të gjithë tashmë jemi të vetëdijshëm se në çfarëdo momenti, me shtypjen të butonit, ai raportim mund të zhduket nëse nuk përputhet me me prioritetet korporative.”

Pjesëmarrësi nr. 3, gazetar i pavarur.

Qasje e kufizuar në informacion dhe ndërhyrje politike

Autoritetet si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi kanë prirje t'u mohojnë mediave të pavarura qasjen në informacione kyçe. Kjo mungesë transparence, përfshirë përgjigjet selektive ndaj gazetarëve, keqpërdorimin e ligjeve për sekret zyrtar dhe kufizimet në përdorimin e dokumenteve publike, pengon llogaridhënien dhe cenon të drejtën e publikut për informim objektiv.

“Si person që raporton nga Beogradi për media ndërkombëtare, kam vënë re sa jashtëzakonisht e vështirë është të marrësh çfarëdo informacioni apo deklarate zyrtare – përveç rasteve kur ato veçse janë shpërndarë përmes mediave të përzgjedhura, miqësore me qeverinë.”

Pjesëmarrësi nr. 6, gazetar në një stacion televiziv në Serbi.

“Kam bërë përpjekje të panumërta për të kontaktuar përfaqësuesit e Listës Serbe para zgjedhjeve, për të shtruar pyetje që as që ishin veçanërisht të ndjeshme, shumica ishin thjesht procedurale, por ishte thjesht e pamundur të depërtoje te ta. Thjesht të injorojnë plotësisht.”

Pjesëmarrësi nr. 1, gazetar në media ndërkombëtare.

Institucionet në Serbi mbeten veçanërisht të dobëta dhe ndikohen fuqishëm nga pushteti politik.

“Ajo që ka ndodhur gjatë dhjetë ditëve të fundit është shumë domethënëse. Sa herë që qeveria ka interes të shtyjë një temë, si tani fushata kundër korrupsionit, menjëherë përmbysen nga mesazhe dhe telefonata. Jo nga ato që kam nisur unë vetë, por nga përfaqësues të Prokurorisë, që më njoftojnë fjalë për fjalë për çdo hap që kanë ndërmarrë ose që do të ndërmarrin.”

Pjesëmarrësi nr. 1, gazetar në media ndërkombëtare.

“Më duhet të them diçka që më ka bërë gjithmonë disi të çuditshme: Zakonisht e kam më të lehtë të marr informacion nga institucionet në Kosovë sesa nga ato në Serbi – dhe kjo është e vërtetë edhe në anglisht edhe në serbisht.”

Pjesëmarrësi nr. 2, gazetar nga e përditshmja në Serbi.

PJESA II: Cilësia e Raportimit

Mungesa e pikëpamjeve të thella dhe perspektivës njerëzore

Cilësia e raportimit të lajmeve mbi marrëdhëniet si bashkësi ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve shihet gjerësisht si e pakënaqshme. Çka është më e dukshme, ekziston një mungesë e plotë e storieve që pasqyrojnë jetën e përditshme të njerëzve në të dyja anët, si dhe mungesë raportimi të lajmeve lidhur me shembuj të bashkëpunimit ndëretnik. Lajmet në mediat kryesore janë kryesisht të përshtatura përmes syrit të tensionit politik, shpesh të nxitura nga sensacionalizmi.

Kjo mungesë informacioni kontribuon në interes të ulët publik dhe kuptim të kufizuar të realiteteve në terren. Në Serbi, mediat rrallëherë raportojnë për zhvillimet në Kosovë.

“Ne po flasim për dy shoqëri që mezi e njohin njëra-tjetrën, në shumë nivele të ndryshme. Ka aq shumë paragjykime të rrënjosura, sa që ato shpesh çojnë në keqkuptime të thella.”

Pjesëmarrësi nr. 3, gazetar i pavarur.

SERBIA		KOSOVA	
Danas	3.962	Kosovo Online	8.151
B92	3.040	Bota Sot	8.118
Informer	2.920	Gazeta Express	6.749
N1	2.886	Balkani info	6.502
Politika	2.745	Demokracia	6.361

Tabela 2. Top 5 mediat online në Serbi dhe Kosovë ku shumica e artikujve ka për temë dialogun Kosovë-Serbi shtator 2023-shtator 2024, Picasa AI

Ngjyrimet polarizuese dhe paragjykimet mediatike

Mediat pro-qeveritare në Serbi më shpesh raportojnë për Kosovën në dritë negative, duke i portretizuar shqiptarët si grup armiqësor. Storit pozitive apo storit e balancuara praktikisht nuk ekzistojnë, siç konkludohet nga gazetarët që raportojnë në gjuhën serbe. Ky lloj raportimi pengon tutje përpjekjet për pajtim dhe thëllon tensionet e gjata etnike që tashmë janë të rrënjosura thellë.

“Gazetat sensacionaliste (tabloidët) dhe mediat pro-qeveritare në Serbi shpesh promovojnë ngjyrimet që portretizojnë serbët e Kosovës si viktimë – duke përdorur gjuhë të ekzagjeruar dhe terminologji të papërshtatshme – duke krijuar njëkohësisht imazhin e një armiku të jashtëm në formën e shqiptarëve. Nga ana tjetër, ne shohim edhe keqinformim në mediat në gjuhën shqipe kur bëhet fjalë për raportimin për komunitetin serb”.

Pjesëmarrësi nr. 4, gazetar i mediave lokale që raporton në gjuhën serbe në Kosovë.

“Ka një dehumanizim të plotë nga të dyja palët, gjë që e bën jashtëzakonisht të vështirë raportimin cilësor. Në mediat me seli në Beograd, veçanërisht në mediat pro-qeveritare, rrallë herë mund të shohësh shqiptarët të shfaqen si burime informacioni apo si të intervistuar.”

Pjesëmarrësi nr. 6, gazetar në një stacion televiziv në Serbi.




Tabela 3. Artikujt e medias dhe statistikën në rrjetet sociale, Picasa AI

Storiet e bashkëpunimit janë të rralla - dhe të rrezikshme

Rrëfime për bashkëpunim mes komunitetit serb dhe atij shqiptar shfaqen rrallë në media, gjë që e bën më të vështirë ndërtimin e besimit dhe çmontimin e paragjytimeve të kahmotshme.

“Ndoshta do të na duhet të shpenzojmë më shumë kohë në terren për të ndërtuar besim të vërtetë – por kjo kërkon mbështetje logjistike dhe teknike. Ju mund të keni sukses në prodhimin e një historie, por gjithmonë lind pyetja se sa interes do të gjenerojë kjo. Storiet e interesave njerëzore kanë potencial për të ndezur komente, por sinqerisht, kjo gjë shpesh është si një llotarie.”

Pjesëmarrësi nr. 10, gazetar në revistë javore serbe.

“Një shembull i një përvoje pozitive është me kolegët shqiptarë nga veriu; ne kemi zhvilluar bashkëpunim shumë të mirë kur bëhet fjalë për shkëmbimin e kontakteve dhe informacionit.”

Pjesëmarrësi nr. 4, gazetar i mediave lokale që raporton në gjuhën serbe në Kosovë.


Gazetarët në grup fokusi identifikuan gjithashtu një sfidë të madhe në trendin për të raportuar vetëm deklaratat e njëres palë – qofshin ato të Serbisë ose të Kosovës – pa mundësinë për të ofruar kontekst ose kundërvënje nga pala tjetër.

“Shpesh shohim situata ku të dy liderët flasin para Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe mediat transmetojnë vetëm fjalimin e Vuçiqit, ose vetëm fjalimin e Kurtit. Kjo tregon një mjedis mediatik ku paraqitet vetëm një perspektivë”


Pjesëmarrësi nr. 13, gazetar kosovar në media ndërkombëtare.

Ky konstatim mbështetet edhe nga të dhënat e Picasa AI, që tregon se presidenti serb Vuçiq dhe kryeministri i Kosovës Kurti janë figurat më të përmendura në raportimin e mediave, në mostrën e përzgjedhur. Vuçiq përmendet 26,299 herë në top 5 mediat serbe, pothuajse po aq sa Kurti me 26,997 herë në top 5 mediat kosovare. Politikanët e tjerë kosovarë dhe serbë kanë dukshëm më pak paraqitje, madje 20 herë më pak.


Top pesë faqet e fansave në Facebook që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë




Top pesë profilet në Instagram që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë




Top pesë kanalet në YouTube që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë




Top pesë faqet e fansave në TikTok që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë




Top pesë profilet në LinkedIn që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë




Top pesë faqet e fansave në Facebook që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë




Top pesë profilet në Instagram që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë



Top pesë kanalet në YouTube që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë



Top pesë faqet e fansave në TikTok që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë



Top pesë profilet në LinkedIn që kanë arritur ndërveprueshmëri të lartë




Tabela 4. Artikujt e medias dhe statistikat në rrjetet sociale, Picasa AI

Një çështje tjetër kritike për gazetarët kosovarë është mungesa e përgjithshme e të kuptuarit se si funksionon qeverisja në Serbi. Gazetarët theksuan se shumë pak gazetarë në Kosovë kanë zotërim solid të njohjes së strukturave politike serbe, duke përfshirë institucionet si presidenca, zyra e kryeministrit ose parlamenti.

“Për shembull, në Klan Kosova është Besnik Tahiri – ai është i vetmi gazetar që i njeh vërtet politikanët serbë me emër dhe me rol. Por tani, ndoshta janë dy-tre të tjerë që e kuptojnë thellë politikën serbe. Edhe ata, megjithatë, nuk po japin lajme për ato çështje në mënyrë diplomatike apo profesionale.”

Pjesëmarrësi nr. 14, gazetar në televizion të Kosovës.

Kjo mungesë mirëkuptimi ka pasoja edhe në nivel lokal. Gazetarët shqiptarë pranian se ata heqin keq për të kryer intervista me qytetarët serbë lokalë – qoftë për ngjarjet në komunitetet e tyre apo sfidat e përditshme me të cilat përballen.

“Kohët e fundit kam hasur në një lajm për dikë që sapo kishte filluar të bënte biznes me Serbinë. Ka pasur shumë komente negative dhe disa media kanë mbajtur qëndrim të qartë kritik ndaj atij personi. Më dukej pak e çuditshme kjo - pse t'i qasemi kësaj kaq negativisht? Të bësh biznes me Serbinë nuk është medoemos gjë e keqe. Personalisht, unë e pashë raportin me një këndvështrim pozitiv – një shqiptar që i është dhënë mundësia për t'u përfshirë në biznese ndërkufitare nuk duhet parë aspak si problem.”

Pjesëmarrësi nr. 15, gazetar në një televizion të Kosovës.

Grupi i fokusit me gazetarët kosovarë diskutoi gjithashtu cilësinë e raportimit në rajonet në Serbi të banuara nga komuniteti shqiptar. Gazetarët vunë re se lajmet mbi Preshevën, Bujanocin dhe Medvegjën shpesh kufizohen vetëm në narrativa të diskriminimit, me pak ose aspak fokus në çështjet e tjera lokale ose veprimet e politikanëve vendorë.

Ata vunë në dukje se ka një tendencë për të shmangur kërkimin e llogarisë nga drejtuesit lokalë lidhur me performancën e tyre, pasi sjellja e tyre shpesh arsyetohet duke u thënë se ka diskriminim edhe më të gjerë.

Mediat që funksionojnë të izoluara

Mediat si në Kosovë ashtu edhe në Serbi funksionojnë kryesisht të izoluara, me shkëmbim minimal të informacionit mes tyre. Kjo rezulton në raportim të njëanshëm dhe shpesh të pasaktë. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet redaksive dhe shpërndarja e përmbajtjes mund të rrisë ndjeshëm cilësinë e informacionit që i vihet në dispozicion publikut.

“Kjo ka efekt edhe te gazetarët në gjuhën shqipe edhe në ata në gjuhën serbe. Shpesh na duket sikur po punojmë mes dy zjarreve.”

Pjesëmarrësi nr. 4, gazetar i mediave lokale që raporton në gjuhën serbe në Kosovë.

“Institucionet zyrtare zakonisht dërgojnë njoftime për shtyp vetëm në gjuhën shqipe. Kur është fjala për Policinë e Kosovës, veçanërisht në rajonin verior, kemi arritur t'i bindim që të fillojnë të dërgojnë deklarata edhe në gjuhën serbe. Megjithatë, ato vijjnë me vonesa dhe përkthimet shpesh janë gramatikisht të pasakta ose të shkruara keq. Ne thjesht nuk mund të garantojmë saktësinë e asaj që po përkthehet.”

Pjesëmarrësi nr. 8, gazetar i mediave lokale që raporton në gjuhën serbe në Kosovë.

“Pothuajse gjithmonë e kam më të lehtë të marr informacion nga institucionet e Kosovës, në anglisht dhe serbisht, edhe pse kryesisht në anglisht. Në anën tjetër, autoritetet serbe tentojnë të injorojnë pyetjet nga disa gazetarë. Është njëfarë ndjenje që, nëse nuk raportoni në favor të tyre, ata thjesht nuk do të përgjigjen.”

Pjesëmarrësi nr. 2, gazetar nga një e përditshme në Serbi.

Lëvizshmëria e kufizuar dhe kufizimet e burimeve

Shumica e gazetarëve në të dy diskutimet në grupe fokusi deklaruan se vizitat e tyre të vetme në Kosovë apo Serbi kanë qenë përmes udhëtimeve studimore të financuara nga donatorët ndërkombëtarë. Ata vunë në dukje se njërive për të cilat punojnë ata u mungojnë burimet financiare për të mbështetur udhëtimet e rregullta ose për të mbajtur korrespondentë në rajone të tjera.

Shumica e gazetarëve thanë se nuk ishin në gjendje të ndiqnin negociatat në Bruksel për shkak të kostove të larta. Në vend të kësaj, ata bazohen në deklaratat e bëra nga liderët politikë pas takimeve, të publikuara zakonisht në mediat sociale. Si rrjedhojë, shumë zhvillime të rëndësishme politike mbulohen ekskluzivisht përmes posteve zyrtare, pa raportime apo analiza të pavarura.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit konfirmuan se ekipet e tyre editoriale nuk investojnë në tema alternative, ku burimet dhe vëmendja më e madhe është e drejtuar drejt mbulimit të krizave dhe mesazheve politike.

Ndikimi i kufizuar i mediave të pavarura dhe roli i mediave lokale

Mediat e pavarura kanë ndikim të kufizuar në formësimin e opinionit publik. Megjithatë, mediat lokale si në Kosovë ashtu edhe në Serbi ofrojnë hapësirë për raportim më të thellë dhe më të saktë për çështje reale, të përditshme. Mbështetja e gazetarisë së pavarur dhe lokale mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e raportimit të lajmeve dhe të kontribuojë në portretizim më objektiv të situatës në terren.

“Qytetari i thjeshtë në Serbi, nëse ndjek transmetuesit shtetërorë apo lexon gazetatat me tirazh të madh, nuk di absolutisht asgjë për Kosovën. Prioriteti i tyre është sensacionalizmi.”

Pjesëmarrësi nr. 9, gazetar dhe redaktor në media lokale në gjuhën serbe në Kosovë.

Tradicionalisht, mediat serbe nuk raportojnë për jetën e shqiptarëve në Kosovë. Ky fakt krijon një vakum informacioni që përforcon paragjykimet dhe thellon ndarjet.

“Nëse njerëzit do të mbështeteshin ekskluzivisht në mediat serbe për informacion, ata nuk do të dinin absolutisht asgjë për jetën në Kosovë, veçanërisht kur bëhet fjalë për komunitetin shqiptar. Kjo do të ishte një pikë e verbër plotësisht. Njerëzit nuk i dinë as gjërat themelore, si për shembull çfarë do të thotë në të vërtetë Rezoluta 1244. Ata nuk do të ishin në gjendje ta shpjegojnë atë me një fjali.”

Pjesëmarrësi nr. 1, gazetar në media ndërkombëtare.

Qasje e kufizuar në komente të ekspertëve dhe komente të paanshme

Raportimi objektiv i lajmeve pengohet ndjeshëm nga disponueshmëria e kufizuar e burimeve që kanë njohuri dhe ato të paanshme. Mediat shpesh përpiqen të gjejnë analistë ose hulumtues të cilët mund të ofrojnë njohuri të balancuara dhe ekspertë për çështjet që mbulohen. Ekziston një nevojë e madhe që media të bazohet më shumë në zëra të tillë për të përmirësuar thellësinë dhe neutralitetin e lajmeve të tyre.

“Mendoj se në Kosovë, në përgjithësi, mediat shqiptare kanë vetëm një korrespondent në Beograd, dhe në shumicën e rasteve është vetëm Idro [Idro Seferi, gazetar kosovar me seli në Serbi], ose nuk kanë fare dikë. Vetëm ky fakt tregon se ne nuk kemi njohuri reale për atë që po ndodh në Serbi,”

Pjesëmarrësi nr. 11, gazetar në media kosovare.

Në mungesë të korrespondentëve, informacionet që vijnë nga Serbia shpesh konsiderohen jo të besueshme. Gazetarët u shprehën se nuk janë të njohur se cilat media të pavarura serbe mund të besohen. Si rezultat, informacionet nga Serbia zakonisht paraqiten në mënyrë të paqartë, zakonisht përshkruhen si “raporte nga mediat serbe”, pa burime apo verifikime të duhura.

Përhapja e dezinformimit dhe ndikimi i tij destabilizues

Dezinformimi është i përhapur dhe lulëzon brenda një mjedisi thellësisht të polarizuar social. Dëmi i shkaktuar nga këto mashtrime shpesh tejkalon edhe nivelin bazë të mosbesimit ndërmjet komuniteteve, duke destabilizuar më tej marrëdhëniet tashmë të brishta ndëretnike.

“Sa më i madh të jetë polarizimi, aq më i fuqishëm bëhet dezinformimi dhe kjo është diçka për të cilën duhet të jemi veçanërisht të ndërgjegjshëm. Dezinformatat që vijnë nga të dyja palët janë ndonjëherë një problem edhe më i madh se mungesa e besimit te vetë politikanët. Këto ngjyrimë shpesh kalojnë nën radar, veçanërisht sa i përket komunitetit serb në Kosovë, por ato kanë potencialin të dëmtojnë seriozisht marrëdhëniet etnike.”

Pjesëmarrësi nr. 4, gazetar i mediave lokale që raporton në gjuhën serbe në Kosovë.

Platformat e verifikimit të fakteve konfirmojnë shkallën e problemit. Sipas të dhënave nga verifikuesit e certifikuar të fakteve, mediat kanë qenë burimi i dezinformimit në dhjetëra raste të dokumentuara, dhe cilësia e përgjithshme e raportimit mbetet e dobët. Vetëm në janar, gjatë fushatës zgjedhore, më shumë se 200 lajme të rreme ose mashtruese u identifikuan në mediat online nga dy platformat me seli në Kosovë, të certifikuara nga Rrjeti Ndërkombëtar i Verifikimit të Fakteve (IFCN).

PJESA III: Zgjidhjet e mundshme

Cilësia e raportimit lidhur me marrëdhëniet Kosovë- Serbi karakterizohet nga mungesa e thellësisë, keqkuptimi i ndërsjellë dhe mungesa pothuajse e ngjyimeve që kanë në qendër njeriun apo histori të bashkëpunimit. Mediat kryesore në të dy kontekstet përforcojnë ndarjet etnike dhe dezinformimin, shpesh duke reduktuar realitetet komplekse në ngjyime të njëanshme politike. Gazetarët shprehën shqetësimin për lëvizshmërinë e kufizuar, investimet e dobëta editoriale në raportimin ndërkomunitar dhe mungesën e korrespondentëve të informuar e dygjuhësh.

Në shqyrtimin e zgjidhjeve të mundshme për sfidat e shumta të identifikuara gjatë këtij raporti, pikënisja ka qenë me mirëkuptim të përbashkët: media luan një rol jetik në uljen e tensioneve dhe nxitjen e ndjeshmërisë midis komuniteteve. Pjesëmarrësit në grupe fokusi parashtruan disa rekomandime konkrete dhe të zbatueshme që synojnë përmirësimin e mjedisit aktual mediatik dhe promovimin e pajtimit:

■ Promovimi i gazetarisë shumë-perspektivëshe

Inkurajimi i raportimit që përfshin këndvështrime të ndryshme nga të gjitha komunitetet përkatëse, nxjerr në pah historitë personale dhe kap jetën e përditshme të njerëzve përtej linjave etnike. Një gazetar i tillë mund të humanizojë “tjetrin” dhe të ndihmojë në çmontimin e paragjyimeve të rrënjosura.

■ Nxitja e bashkëpunimit mediatik dhe projekteve të përbashkëta

Gazetarët dhe organet e medias duhet të inkurajohen të ndërtojnë partneritete afatgjata, të angazhohen në nisma të përbashkëta raportuese dhe të shfrytëzojnë bashkë burimet, kontaktet dhe ekspertizat. Krijimi i mbështetjes reciproke ndërmjet redaksive, veçanërisht ndërmjet ndarjeve etnike, duhet të bëhet praktikë standarde dhe jo përjashtim.

■ Krijimi i mundësive për angazhim ndërkomunitar

Duhet të zhvillohen hapësira të dedikuara për gazetarët me prejardhje të ndryshme për t’u takuar, shkëmbyer ide dhe për të ndërtuar besimin profesional. Një ide e propozuar është formimi i një shoqate multietnike të gazetarëve për të lehtësuar bashkëpunimin dhe përfaqësimin në të gjithë peisazhin mediatik.

■ Avokimi për sundimin e ligjit dhe përgjegjshmërinë profesionale

Ekziston një nevojë urgjente për të avokuar publikisht për zbatimin e vazhdueshëm të ligjeve të medias, udhëzimeve etike dhe standardeve profesionale. Institucionet, rregullatorët e medias, organet vetërregulluese dhe vetë organizatat e medias duhet të mbajnë përgjegjësi për shkeljet.

■ Sigurimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale

Përpyekjet e avokimit publik duhet të fokusohen te rritja e hapjes institucionale, duke theksuar detyrën e autoriteteve për të bashkëpunuar me gazetarët, për t’iu përgjigjur pyetjeve nga mediat dhe për të ofruar qasje të përpiktë në informacion publik.

■ Forcimi i financimit afatgjatë dhe programeve të shkëmbimit

Ekziston një nevojë kritike për mbështetje financiare drejtuar projekteve të qëndrueshme dhe afatgjata që mundësojnë raportim të thelluar në terren dhe shkëmbim ndërkufitar të gazetarëve. Lëvizshmëria e shtuar, koha e kaluar në terren dhe nismat e përbashkëta editoriale janë thelbësore për ndërtimin e besimit dhe prodhimin e raporteve më të sakta dhe empatike.

PRILL 2025.



Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e BIRN Serbia dhe Internews Kosova dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë si reflektim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.